



[ Data : 05.05.2017]

**Për: Operatorin Ekonomik “B 93” shpk**

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **"Sistemimi dhe asfaltimi I rruges "Mertish - Tre Ura".**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Sistemimi dhe asfaltimi I rruges "Mertish - Tre Ura".**

Kohëzgjatja: brënda 4 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 45.850.000 (dyzet e pesë milion tetëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

Fondi i akorduar për vitin 2017 është 9.170.185 (nëntë milion njëqind e shtatëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) Lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 13.04.2017.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

Nr	Shoqëria	Oferta lek pa tvsh para kontrollit aritmetik
1	B 93	33,777,777
2	Elira shpk & Murati shpk	34,270,908
3	Mela shpk & Alb Shpresa shpk	35,000,000
4	Shkelqimi 07 shpk	35,000,000
5	Bahas shpk & Avduli shpk	36,644,140
6	Caushi shpk & Boshnjaku B	38,154,100
7	Aurora Konstruksion	38,890,400

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

**1. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Elira” shpk (80%) dhe “Murati” shpk (20%) per arsye se:**

Shoqeria “Elira” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me stafin pasi nuk ka te punesuar nje inxhinier transporti.

Shoqeria “Murati” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me stafin pasi nuk ka te punesuar nje inxhinier transporti.

Shoqeria “Murati” shpk nuk ploteson piken 2.3.5 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me mjekun pasi nuk ka mjek te punesuar.

**2. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Bahas” shpk (95%) dhe “Avduli” shpk (5%) per arsye se:**

Shoqeria “Bahas” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi ka paraqitur dokumentacion per punen “Rikonceptimi i qendres Selenice” por ne kete objekt nuk ka as nje meter katror asfaltim. Ne kete menyre ky objekt nuk mund te konsiderohet si objekt i ngjashem.

**3. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Boshnjaku B” shpk (43.31%) dhe “Caushi” shpk (56.69%) per arsye se:**

Shoqeria “Boshnjaku B” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Gjirokaster nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria “Caushi” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, nga viti 2016 ushtron aktivitet ne Kukes, Memaliaj, Peqin, Berat, Vrrine. Per keto objekte nuk ka paguar detyrimet vendore dhe nuk e ka regjistruar ne QKB. Per rrjedhoje edhe deklarata e paraqitur ne perputhje me kriterin 2.2.5 per kualifikim rezulton te jete e rreme.

**4. Te skualifikoje shoqerine “Aurora Konstruksion” shpk per arsye se:**

Nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi ka paraqitur dokumentacion per nje pune te ngjashme me vlere 27.319.032 leke me tvsh, e

pamjaftueshme per te plotesuar kerkesen per kualifikim. Punet e tjera jane ndertime e rikonstruksione godinash, te cilat nuk mund te konsiderohen si pune te ngjashme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “B 93” shpk** se oferta e paraqitur, me vlerë **33.777.777 (tridhjetë e tre milion e shtatëdhjetë e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e shtatë )** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **27.04.2017**.

Ankesa nuk ka patur. Afatet e ankimit kane perfunduar.